



Këshilla Zero Mbetje

**Të reduktojmë hap pas hapi mbetjet
tona dhe gjurmën tonë ekologjike**



refuzojmë

reduktojmë

rimendojmë

ripërdorim

riparojmë

Së bashku, të konsumojmë më pak dhe më mirë!

Zero Mbetje është “konservimi i të gjitha burimeve nëpërmjet prodhimit, konsumit, ripërdorimit dhe rikuperimit të përgjegjshëm të produkteve, ambalazheve dhe materialeve, pa djegie, dhe pa asnjë shkarkim në tokë, ujë ose ajër që kërcënon mjedisin ose shëndetin e njeriut”.

Përkufizimi i Zero Mbetje siç është miratuar nga Aleanca Ndërkombëtare Zero Waste.

Pse të reduktojmë?

Konsumi në mënyrë të qëndrueshme lejon të kufizohen ndryshimet klimatike, shpërdorimi i burimeve natyrore dhe ndotja e mjedisit tonë.

Objektivi i Zvicrës* :
Neutraliteti klimatik
'deri më 2050

*Konfederata Zvicerane:
[Objektivi zero neto deri më 2050](#)

“Mbetja më e mirë është ajo që nuk ekziston!”

Lajmi i mirë, ju mund të kontribuoni në nivelin tuaj:

Çdo veprim ka rëndësi!

Do të donit t'i reduktoni mbetjet tuaja, të fitoni kohë, të kurseni dhe të kontribuoni në parandalimin e ndryshimeve klimatike?

Parimet e Zero Mbetje


Zero Mbetje është një qasje që synon të reduktojë, me disa veprime të thjeshta dhe progresive, gjurmën tonë karbon, duke filluar nga pjesa e dukshme e ajsbergut, mbetjet tona.

Parimet e Zero Mbetje zbatohen në çdo situatë të përditshme. Ja 4 pikat e tyre, **për t'u zbatuar sipas këtij rendi:**

- 1 Të refuzojmë & të mendojmë**
Para se ta blejmë ose projektojmë një produkt
- 2 Të reduktojmë**
Tepërcat dhe ambalazhet e tepërta
- 3 Të ripërdorim & të riparojmë**
Objekte të qëndrueshme, enë të ripërdorshme
- 4 Të kompostojmë & të riciklojmë**
Atë që nuk mund të riparohet ose ripërdoret

Energjia gri

Energjia gri përfaqëson lëndët e para dhe energjinë e përdorur për prodhimin, ambalazhet dhe transportin e mallrave tona të konsumit para se t'i gjejmë në dyqan.



Disa veprime të thjeshta

Unë blej pa ambalazh

- Bukën në çantën time prej cope
- Orizin, bishtajoret dhe makaronat me peshë
- Frutat dhe perimet në shportën time
- Djathin, biskotat, mishin etj. në enët e mia
- Sapun dhe shampo të ngurta
- Detergjent rrobash dhe enësh në shishen time



Unë ripërdor

- Paguren e ujit
- Filxhanin për pijet që merren me vete
- Setin take-away (takëme, pecetë, gotë)
- Ambalazhe të kthyeshme (verë, birra, qumësht, ushqim për vaktin e drekës)
- Peceta për heqjen e grimtës që lahen
- Brisk sigurie, furçë dhe sapun rroje
- Mbrojtje higjienike që mund të lahen
- Dyllë blete për të mbuluar ushqimets



Unë favorizoj ekonominë qarkulluese

- Sende të përdorura (veshje, mobilie, artikuj elektronikë, lodra)
- Riparime (biçikleta, materiale elektronike, mobilie)
- Marrje me qira dhe shkëmbime (libra, lojëra, lodra, veshje)
- Dhurime dhe huazime objektsh
- Dhënie vlerë lëndës organike (mbetjet e gjelbra)



Unë reduktoj shpërdorimin dhe ndotjen

- Gatuaj ato që kanë mbetur
- Më pak mish dhe produkte bulmeti
- Produkte vendore dhe të stinës, bio, nëse është e mundur
- Veshje prej fibrash natyrore
- Uthull dhe sodë buke për të pastruar
- Stop reklamave (stiker, lista Robinson, email)
- Rimendoj lëvizjen time (reduktoj përdorimin e veturës, kufizoj avionin)
- Zvogëloj distancën për pushimet, udhëtoj afër
- Seleksionoj mbetjet organike dhe të riciklueshme



Veprimi juaj ka rëndësi

Duke reduktuar mbetjet tuaja, ju kontribuoni në **reduktimin emetimeve të CO₂**

Çdo objekt në duart tuaja, ka gjeneruar emetime të CO₂, ka konsumuar ujë dhe energji në çdo etapë të ciklit të jetës (nxjerrje, transformim, ambalazhim, transport, magazinim). Këto quhen mbetjet e fshehura ose energjia gri.

Reduktojmë groposjen në landfill

Djegia e mbetjeve prodhon 200 kg skorie për ton. Këto janë mbeturina të ngurta të materialeve të ndryshme që i rezistojnë djegies. Ato janë të grumbulluara në landfille.

Reduktojmë ndotjen plastike

Prodhimi i plastikës vazhdon të shtohet. 50% janë produkte me një përdorim. Mikroplastikat ndotin ujin, ajrin tokën.

Një konsum i matur lejon:

- ✓ Kursime
- ✓ mbështetjen e dyqaneve dhe prodhuesve vendorë
- ✓ krijimin e vendeve të punës në rajon

Si të ecim përpara ...

Frymëzojmë

Zgjidhni 3 aksione për t'i zbatuar në familjen tuaj. Si të jenë përvetësuar veprimet e duhura, kaloni te veprimet pasuese.

Aktivizojmë

Flisni me rrethin tuaj, ndërmarrjen tuaj, kolegët tuaj, familjen tuaj. Tregohuni shembullorë për të frymëzuar të tjerët.

Përfshijmë

Bashkojuni dhe mbështesni lëvizjen Zero Mbetje në Zvicër dhe veproni si ambasador-e, militoni politikisht, zgjidhuni.

Kështu ju merrni pjesë në krijimin e botës së të nesërmes.

Kush jemi ne?

Zero Waste Switzerland është një shoqatë e pavarur, apolitike, jo fitimprurëse që ndihmon në reduktimin domethënës dhe të qëndrueshëm të mbetjeve.

Zakonet e mia të reja Zero Mbetje

Shënime personale

Mbetjet e mia sot

Sa është sasia aktuale e mbetjeve të mia?

(Përveç kompostimit dhe riciklimit. Në kilogramë ose në numër qesesh)

.....

.....

.....

Njohuri të reja

Cilat janë mësimet e përfituara?

(Këshilla të dobishme, dyqane për t'u vizituar, faqe web, iniciativa për t'u ndjekur, veprimtari për të organizuar...)

.....

.....

.....

Plani i veprimit

Zakonet e reja Zero Mbetje që do të provoj.

Tri etapat e ardhshme:

1)

.....

.....

.....

2)

.....

.....

.....

3)

.....

.....

.....

Kur synoj t'i bëj?

.....

Si mund t'i bëj?

.....

.....

.....



Mbështesni lëvizjen Zero Waste, punën tonë,
bëhuni anëtar ose bëni një donacion:



zerowasteswitzerland.ch



info@zerowasteswitzerland.ch



Link-e dhe rrjete sociale të dobishme:
[ZeroWasteSwitzerland.ch/links](https://zerowasteswitzerland.ch/links)